



REPUBLIKA E SHqipërisë  
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

## NJOFTIM

Bazuar në VKM nr. 101, datë 09.02.2022 “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimit rural për vitin 2022”, në Udhëzimin nr. 1, datë 11.02.2022 “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, në VKM nr. 568, datë 6.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” ju bëjmë me dije se:

1. Për aplikimet e masave të investimeve, AZHBR do të pranojë nëpërmjet Zyrës së Protokollit, dosjet e aplikimit me dokumentacionin përkatës dhe plotëson formularin e pranimit. Një kopje e këtij formulari i jepet aplikantit/përfaqësuesit.

2. Suporti nga AZHBR do të jetë çdo ditë pune brenda orarit zyrtar në kanalet si më poshtë:

- Nr Jeshil **0800 8383** AZHBR
- Nr Jeshil **0800 0118** ADISA
- Email [info@azhbr.gov.al](mailto:info@azhbr.gov.al)
- Përmes informacioneve që kërkohen në kanalet zyrtare të komunikimit online të AZHBR (Facebook, Instagram, etj).

3. Shërbimi Online Call Center nga ADISA do të jetë çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në 19:00.

4. Fillimi i pranimit të Aplikimeve për masat Online do të jetë data 25/02/2022 ora 08:00, deri në datë 25.03.2022, ora 24:00.

Çdo aplikim përtej këtyre afateve nuk do të konsiderohet.

5. Pranimi i aplikimeve për masat e investimeve, kryhet nëpërmjet Zyrës së Protokollit AZHBR në adresën “Rr. Muhamet Gjollesha, Nr 56”, Tiranë, do të bëhet çdo ditë pune brenda orarit zyrtar.

Ju urojmë aplikim të mbarë!